VENDIM
Nr.570, datë 28.5.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË LUSHNJË TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Lushnjë të qarkut të Fierit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Lushnjë të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr.285, datë 17.5.2006 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Lushnjës të qarkut të Fierit".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Lushnjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Lushnjë Lidhja nr.1

Numrat rendor të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
440, 446	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative	Në pronësi
1-9,11-24,26-52	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
251-254	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shërbimit social	Në pronësi
240,241,243-245	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
53-75	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
362-367	Varreza publike	Në pronësi
361,3281-3295,3296-3880	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike.)	Në pronësi
448-3280	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
255-360	Prona që pëdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
170-179	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

3930-3933,3936,3938-3942,3944-3950	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
3934,3935,3937,3943,4051, 4055,4057,4059,4061-4063,4065-4068,4073-4083, 4085,4087-4102,4106,4112-4115,4117-4119,4122-4134,4136-4149,4152,4154,4157-4161,4165,4166,4187-4201,4203	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit. (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
368-415,3881-3912,3959-3962	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi